

17 Prill, 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën 25 të Privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot zyrtarisht shpalli valën 25 të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 5 prill, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitatet përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, www.kta-kosovo.org.

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës së 25-të janë përfshirë 29 Ndërmarrje Shoqërore (NSH), nga të cilat janë krijuar 45 Ndërmarrje të Reja (Ndër. të Reja).

Të gjitha ndërmarrjet do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt.

Afati i fundit për parakualifikim është me: 13 qershor, 2007.

Data për dorëzimin e ofertave është me: 20 qershor, 2007.

Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të kompanive:

Ndërmarrja e Re Kompleksi Agro – industrial A Sh.P.K. - Kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së Fermës së Bibave nr.5 të Agrokulturës dhe Fermën e Dhive që gjendet në fqinjësi me një sipërfaqe të përafërt prej 5 hektarësh. Ferma e Dhive përmban ndërtesat prodhuese të gjëra me rreth 1,770 m² dhe ndërtesat shtesë me një sipërfaqe prej afro 920 m² dhe silosin me 4 hangarë. Ferma e Qurrave përmban: ndërtesat e prodhimit që përfshijnë përafërsisht 5,400 m² dhe ndërtesën e administratës me ndërtesat shtesë me një sipërfaqe të përafërt prej 214 m². Ndërmarrja e Re për momentin përdoret nga një qiramarrës i cili prodhon sfungjer industrial.

Ndërmarrja e Re Kompleksi Agro – industrial B Sh.P.K. - kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së Fermës së Bibave nr.4 të Agrokulturës me një sipërfaqe të përafërt prej 2,5 hektarësh. Ndërtesat përfshijnë: Ndërtesat prodhuese që përfshijnë përafërsisht 5,000 m² dhe ndërtesën e administratës me ndërtesat shtesë me një sipërfaqe të përafërt prej 337 m². Ndërmarrja e Re për momentin përdoret nga një qiramarrës i cili planifikon të prodhojë ujë të distiluar për akumulator.

Ndërmarrja e Re Kompleksi Agro – industrial C Sh.P.K. - kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së Fermës së Bibave nr.3 të Agrokulturës me një sipërfaqe të përafërt prej 2,5 hektarësh. Ndërtesat përfshijnë: Ndërtesat prodhuese që përfshijnë përafërsisht 5,000 m² dhe ndërtesën e administratës me ndërtesat shtesë me një sipërfaqe të përafërt prej 400 m². Ndërmarrja e Re për momentin përdoret nga një qiramarrës i cili i përdorë ndërtesat për rritjen e zogjve të pulës.

Ndërmarrja e Re Kompleksi Agro – industrial D Sh.P.K. - kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së Fermës së Bibave nr.2 të Agrokulturës me një sipërfaqe të përafërt prej 3 hektarësh. Ndërtesat përfshijnë: Ndërtesat prodhuese që përfshijnë sipërfaqe të përafërt prej 5,000 m² dhe ndërtesën e administratës me ndërtesat shtesë me një sipërfaqe të përafërt prej 400 m². Ndërmarrja e Re për momentin përdoret nga një qiramarrës i cili i përdorë ndërtesat për prodhimin e mobileve.

Ndërmarrja e Re Kualiteti International Sh.P.K. - oferta për Ndërmarrje e Re përmban njësinë në Gjilan me një sipërfaqe prej mbi 14,800m². Ka objekte të numërta industriale brenda kesaj hapësire, duke përfshirë ketu drithnikun e grurit. Sipërfaqja e përgjithshme e objekteve llogaritet të jetë përafërsisht 10,000m². Bluarja e grurit me këmbim dhe drithniku, prodhimi i bukës dhe prodhime tjera nga pjekja e brumërave.

Ndërmarrja e Re tokë bujqësore në Bibaj Sh.P.K. - kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së tokës me vlerë me sipërfaqe prej 130ha, i cili ka potencial të zhvillimit të mire bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes së Re ndodhet afër 500m në veri të fshatit Bibaj dhe shtrihet në drejtim të fshatit Talinocë në drejtim të magjistrales Prishtinë - Shkup. Për momentin përdoret për kultivim të grurit.

Ndërmarrja e Re tokë bujqësore në Talinoc Sh.P.K. - kjo ofertë ofron mundësin e blerjes së tokës me vlerë me sipërfaqe prej of 70ha, i cili ka potencial të zhvillimit të mire bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes së Re ndodhet 1 km në lindje të magjistrales Prishtinë - Shkup afër fshatit Talinoc. Për momentin përdoret për kultivim të grurit.

Ndërmarrja e Re Grafikos Sh.P.K. - është një shtypshkronjë e madhe që merret me shërbimet kontraktuese, e cila gjendet në afërsi të qendrës së Gjilanit. Asetet kryesore të Ndërmarrjes së Re përbëhen nga reputacioni , biznesin dhe klientët e Grafikosit si dhe shtypshkronjën që gjendet në qytetin e Gjilanit që së bashku me objektin e administratës përbëjnë 1,433 m². Objekti është i ndërtuar në vitin 1977 dhe është në gjendje të mirë. Sipërfaqja totale e tokës brenda rrethojës është 3,510 m².

Ndërmarrja e Re Ferma Turigevci Sh.P.K. - ndodhet në komunën e Skenderaj dhe përfshin një sipërfaqe prej përafërsisht 215 hektarë tokë tokë të lërueshme të fermës.

Ndërmarrja e Re Ferma Mikushnice Sh.P.K. - ndodhet në komunën e Skenderaj dhe përfshin një sipërfaqe prej përafërsisht 204 hektarë tokë tokë të lërueshme të fermës.

Ndërmarrja e Re Ferma Kline e Poshtme Sh.P.K. - ndodhet në komunën e Skenderajt dhe përfshinë një sipërfaqe prej përafërsisht 91 hektarë tokë të lërueshme të fermës.

Ndërmarrja e Re Lux Granap - Meteor Sh.P.K. - përfshin një sipërfaqe totale prej 140m². Dyqani ka një sipërfaqe prej rreth 90m² dhe 50m² tokë prapa dyqanit.

Ndërmarrja e Re Lux Granap - Dedinje Sh.P.K. - përfshin një sipërfaqe totale prej 148m². Dyqani ka një sipërfaqe prej rreth 100m² dhe 48m² tokë prapa dyqanit.

Ndërmarrja e Re Agroqendra Sh.P.K. - gjendet në Polac të Vjetër, Komuna e Skenderajt në parcelën 1316/0, lista poseduese nr 228. Agro-qendra është një ndërtesë përdhese dhe ka sipërfaqe përafërsisht 492 m².

Ndërmarrja e Re Ndërtesa e Administratës e Ekonomisë së Pyjeve – Vushtrri Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial mundësinë ideale për të përfituar rreth 9253 m² (92are 53m²) toke ,duke përfshirë ndërtesën me sipërfaqe prej 200m² , dhe tokë të punueshme me sipërfaqe prej 9053 m² , te përshtatshme për qdo llojë veprimtarie. Ndërtesa dhe toka gjenden në një lokacion shumë të përshtatshëm,në afërsi të qendrës së Vushtrrisë.

Ndërmarrja e Re Pylltaria Kodra e Çitakut Sh.P.K. - në Çitak, Skenderaj i ofron investitorit potencial mundësinë ideale për të përfituar rreth 138913 m² (13ha 89are 13m²) tokë (kullosë) të përshtatshme për çdo llojë veprimtarie, dhe me një lokacion shumë të mirë afër rrugës kryesore Runik-Pejë në fshatin Çitak.

Ndërmarrja e Re NT Klina – Shitorja nr. 4 Sh.P.K. - i ofron investitorëve një lokacion atraktiv për shitje me pakicë në qendër të Klinës. Ndërtesa ofron një sipërfaqe prej rreth 87.1 m²

Ndërmarrja e Re KB Shtupel – Ndërtesa administrative Sh.P.K. - përfshin ndërtesën administrative dhe depon në Shtupel, Klinë në një sipërfaqe prej rreth 1 hektar, 8 ari dhe 38 m².

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Kosuriq Sh.P.K. - i ofron investitorit tokë bujqësore me sipërfaqe 220 ha. Lokacioni është afër Deçanit.

Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Dyqani Kurrizi Sh.P.K. – ofron investitorëve potencial mundësinë që të fitojë lokalit afarist në vendin kyç në lagjen Kurrizi në Prishtinë. Lokali përfshin dyqanin që gjendet në katin e parë të ndërtesës dhe podrumin në katin përdhese, të gjitha me sipërfaqe prej 251.51 m².

[Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Dyqani Fushë Kosovë Sh.P.K.](#) – ofron investitorëve potencial mundësinë që të fitoj lokalit afarist me sipërfaqe përafërsisht prej 143.81 m², e cila gjendet në katin përdhës të ndërtesës në qendër të Fushë Kosovës.

[Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Zyret Zona Industriale Sh.P.K.](#) – ju ofron blerësve potencial mundësi për lokale afariste (një kat) me përafërsisht 557 m² dhe oborr me një sipërfaqe përafërsisht prej 7,089 m² që gjendet në një vend kyq në zonën industriale të Prishtinës në drejtim të Fushë Kosovës.

[Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Depoja në Zonën Industriale Sh.P.K.](#) - ju ofron blerësve potencial mundësi për lokale afariste (një kat) me përafërsisht 2000 m² dhe oborr me një sipërfaqe përafërsisht prej 4,200 m² që gjendet në zonën industriale të Prishtinës.

[Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Depoja te Hekurudha Sh.P.K.](#) – ju ofron blerësve potencial mundësi për lokale afariste (një kat) me përafërsisht 471 m² dhe oborr me një sipërfaqe përafërsisht prej 3,450 m² që gjendet qytetin e Prishtinës afër hekurudhës.

[Ndërmarrja e Re Gërmia Shitorja Fushë Kosovë 2 Sh.P.K.](#) - u ofron klientëve potencial mundësinë që të kenë në pronësi një lokal operues për mundësi biznesi në qendër të qytetit të Fushë Kosovës. Lokali posedon një hapësirë prej 460 m² që ndodhet në katin përdhës të ndërtesës rezidenciale.

[Ndërmarrja e Re Shtime Tokë Bujqësore Sh.P.K.](#) - ofron tokë shumë të mirë bujqësore me përafërsisht 1785109 m² (178 ha 51 ari 09 m²) si dhe ndërtesa administrative gjendet në lokacion shumë strategjik. Me investime të vogla do të ketë rritje të prodhimeve.

[Ndërmarrja e Re DUHANI Pejton Sh.P.K.](#) - ofron investitorit potencial mundësinë që të fitoj hapësirat afariste në një vend qendror, afër qendrës së Prishtinës, saktësisht në lagjen Pejton. Sipërfaqja totale e hapësirës afariste që është pjesë e këtij tenderi përfshin 535 m². Aktualisht, hapësira e këtij tenderi është dhënë me qira Pasticerisë "Fellini".

[Ndërmarrja e Re Llapi Shitorja Nr. 1 dhe Shitorja Nr. 2 Sh.P.K.](#) - ju ofron investitorëve potencial dy shitore (të njohura si Llapi Shitorja Nr.1 dhe Llapi Shitorja Nr.2) me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 114 m² dhe oborr prej përafërsisht 51 m². Lokalet gjenden në një ngastër të vetme dhe në një lokacion kyq në qendër të Podujevës.

[Ndërmarrja e Re Llapi Shitorja Nr. 23 dhe Shitorja Nr. 38 Sh.P.K.](#) - ju ofron investitorëve potencial mundësinë për dy hapësira afariste në dy vende të ndara më sipërfaqe totale në tërësi prej përafërsisht 204 m². Lokalet e transferuara janë të njohura si Llapi Shitorja Nr.23 prej përafërsisht 72 m² dhe Llapi Shitorja Nr.38 prej përafërsisht 70 m² hapësirë, më oborr prej përafërsisht 62 m². Këto dy lokale gjenden në Podujevë dhe jo larg njëra tjetrës.

[Ndërmarrja e Re Urata Hipermarketi Sh.P.K.](#) - i ofron mundësinë investitorit potencial përfitimin e pronës afariste me përafërsisht 1,208 m² (e ndarë në 34 njësi me hapësirë kalimi në mes të njërive) e cila gjendet në rrugën UÇK në qendër të Prishtinës në pjesën e njohur si Qafa. Kjo pronë gjendet në katin përdhës të qendrës tregtare dy-katëshe nën ndërtesat për banim.

[Ndërmarrja e Re Urata Supermarketi Kurriz Sh.P.K.](#) - i ofron mundësinë investitorit potencial përfitimin e pronës afariste me përafërsisht 194 m² (e ndarë në 8 njësi me hapësirë kalimi në mes të njërive) e cila gjendet në qendrën tregtare Kurriz në lagjen Dardania në Prishtinë.

[Ndërmarrja e Re Rilindja Rrjeti Tregtar - Libraria Nr. 6 Sh.P.K.](#) - ofron mundësinë investitorit potencial për përfitimin e hapësirës afariste që përfshijnë përafërsisht 111,48 m². Dyqani përbëhet prej dy niveleve/kateve dhe gjendet në qendrën tregtare të njohur "Kurrizi" në Dardani/Prishtinë. Aktualisht, dyqani është i lëshuar me qira në baza komerciale.

[Ndërmarrja e Re Dardania Arbëria Sh.P.K.](#) - i ofron investitorit potencial mundësinë e fitimit të një toke shumë atraktive duke përfshirë edhe disa ndërtesa si zyre dhe depo që gjenden në Prishtinë. Sipërfaqja totale e tokës e cila është pjesë e këtij tenderi është 13,125 m² dhe gjendet në Arbëri/Prishtinë. **(Depoziti i Ofertës - 20.000€)**

[Ndërmarrja e Re Krajkovë Sh.P.K.](#) - me rreth 390.63.91 hektarë të tokës/bujqësore së bashku me shtallat e lopëve. Ndër. e Re shtrihet në Zonat Kadastrale të fshatrave Krajkovë, Zabel i Ulët, Shtrubullova, Qikatovë e Re, dhe Lapushnik. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore kategorizohet në klasën e 3 dhe 4 dhe shtrihet afër magjistrales Prishtinë-Pejë. Në këtë Nder. të Re gjenden 6 objekte të fermave për vija në gjendje relativisht të mirë një objekt i administratës.

Ndërmarrja e Re Zabeli i Ulët Sh.P.K. - me rreth **179.85.71** hektarë të tokës bujqësore (nuk ka ndërtesa). Shtrihet në Zonat Kadastrale; Zabel i Ulët, Zabel i Epërm dhe Korreticë e Ulët, shumica e tokave kategorizohet në klasën e 4 dhe ka qasje në ujitje. Shtrihet skaj magjistrales Prishtinë – Pejë.

Ndërmarrja e Re Zabeli i Epërm Sh.P.K. - me rreth **93.05.23** hektarë të tokës bujqësore (nuk ka ndërtesa). Shtrihet në Zonat Kadastrale Zabel i Epërm dhe Sankoc. Pjesa më e madhe e tokës kategorizohet në klasin e 4 dhe ka sistem të ujitjes. Edhe kjo tokë shtrihet afër Magjistrales Prishtinë - Pejë.

Ndërmarrja e Re Komoran Sh.P.K. - me rreth **73.31.72** hektarë të tokës bujqësore (nuk ka ndërtesa). Shtrihet në Zonat Kadastrale Komoran dhe Llapushnik. Pjesa më e madhe ka ujitje dhe kategorizohet në klasën 4-5, gjindet skaj magjistrales Prishtinë – Pejë.

Ndërmarrja e Re Liria Tregu i Veturave dhe Kafshëve Sh.P.K. - përfshin sipërfaqen prej përafërsisht 61,81.50 hektarë (618150 m²). dhe gjendet buzë rrugës kryesore ndërmjet Prishtinës dhe Podujevës, rreth 5 kilometra larg qendrës së Prishtinës. **(Depoziti i Ofertës - 20.000€)**

Ndërmarrja e re Prizrencoop Prizren - Shitorja Sh.P.K. - prona e ndërmarrjes për tu bartur në subjektin e ri përmban shitoren që ndodhet ne rrugën kryesore të Prizrenit dhe përmban një sipërfaqe prej përafërsisht 138m².

Ndërmarrja e Re Liria "Shtëpia e Mallrave" Sh.P.K. - shtëpia e mallrave përmban bodrumin, përdhësën dhe katin e parë/galleria me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 0.19.60 Ha (1960m²). Kompleksi i shitjes me pakicë/shtëpia e mallrave gjendet në rrugën "Sheshi i Shatravanit" në qendër të qytetit. Aktualisht shtëpia e mallrave është dhënë me qira palëve të treta.

Ndërmarrja e Re Podrima – Shitoret Rahovec Sh.P.K. - gjendet në pjesën atraktive të qytetit të Rahovecit dhe përfshin një Kompleks të Shitoreve. Kjo Ndërmarrje Subsidiare përfshin 4 shitore në Rahovec me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 541.5 m². Podrima është një prej kompanive kryesore për tregti dhe shitje me pakicë në Regjionin e Prizrenit që gjendet në qytetin e Rahovecit dhe fshatrat përreth.

Ndërmarrja e Re Zhupa Reçan – Supermarketi dhe Restoranti në Sredskë Sh.P.K. - përfshin **Supermarketin** i cili gjindet në pjesën atraktive të fshatit Sredskë cila përfshinë ndërtesën një katëshe me bodrum me një sipërfaqe prej 275 m² dhe oborr me sipërfaqe prej 473 m² si dhe **Restorani** i cili përfshinë ndërtesën një katëshe me bodrum me një sipërfaqe prej 140 m² dhe oborr me sipërfaqe prej 229 m² që gjendet në anën e kundërt të Supermarketit në fshatin Sredska.

Ndërmarrja e Re 25 Maji – Vetëshërbimi Duhël Sh.P.K. - prona e ndërmarrjes për tu bartur në subjektin e ri përmban ndërtesën/vetëshërbimin që ndodhet përgjatë rrugës kryesore Prizren – Prishtinë në fshatin Duhël dhe ka një sipërfaqe prej përafërsisht 4 ari 94 m². Vetëshërbimi aktualisht është dhënë me qira palës së tretë.

Ndërmarrja Re Sharrprodhimi "Fermat në Mejdani" Sh.P.K. - do të përfshijë në sipërfaqe totale të përafërt me 450 hektarë të tokës duke përfshirë edhe ndërtesa (7) secila prej të cilave ka në sipërfaqe të përafërt me 1,500 m² të cilat janë të regjistruara në emër të NSH-s.

Ndërmarrja e Re "Thertorja-Exportuese" Sh.P.K. - është një kompani atraktive të përpunimit të mishit dhe është i vetmi prodhues i licencuar në regjionin e Prizrenit. Ndërmarrja prodhuese gjendet në zonën industriale dhe ka një sipërfaqe përafërsisht 1.76.61 hektarësh, duke përfshirë 3 njësitë punuese dhe ndërtesën e administratës.